



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA

		REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA INSTITUTI HISTORISË – INSTITUTE OF HISTORY – INSTITUT ZA ISTORIJU	
Njësia Org. Org. Unit. Org. Jed.	1.14	Nr. i prot. Prot. No. Br. Prot.	01/36/24
Nri.Faqeve No. Pages Br. Stranica	11	Data: Date: Datum:	14.05.24

INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI” PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY “ALI HADRI” PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU “ALI HADRI” PRIŠTINA

Prishtinë, 10.05.2024

RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES

për zgjedhjen e kandidatit për vendin e punës:

Bashkëpunëtor i lartë shkencor për shekullin XX – zgjedhje/rizgjedhje

Bazuar në konkursin e shpallur nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, të publikuar gazetën “Epoka e Re” të datës 5 prill 2024 dhe në ueb faqen e Institutit të Historisë “Ali Hadri” Prishtinë <https://ih-rks.org/konkurse/Konkurs-Bashkepunetor-i-larte-shkencor-5.4.2024.pdf>, bazuar në nenet 30, 31, 33 dhe 35 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, neneve 29, 30, 31, 32, 33 dhe 34 të Statutit të Institutit të Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, dhe nenet 3, 5, 9, 11, 12 dhe 13 të Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin e Historisë “Ali Hadri” Prishtinë, si dhe bazuar në vendimin e datës 19.03.2024, Komisioni recensues për vendin e punës *Bashkëpunëtor i lartë shkencor për shekullin XX– zgjedhje/rizgjedhje*, në përbërje prof. dr. Sabit Syla - kryetar, prof. dr. Ibrahim Gashi, – anëtar, dhe Prof. assoc. Dr. Alban Dobruna – anëtar, i paraqet Këshillit Shkencor të Institutit të Historisë “Ali Hadri” Prishtinë, këtë:

RECENSION

për kandidatin

Mbështetur në dokumentet dhe dispozitat ligjore mbi të cilat është shpallur konkursi i cekur më sipër si dhe në dosjen e kandidatit të paraqitur, Komisioni recensues ka konstatuar se në konkursin për vendin e punës *Bashkëpunëtor i lartë shkencor për shekullin XX– zgjedhje/rizgjedhje*, ka konkurruar vetëm kandidati Haxhi Ademi.

Komisioni recensues pas verifikimit të dokumentacionit relevant dhe mbështetës, të nevojshëm dhe të dëshmuar në CV përkatëse, konstatoi se kandidati Haxhi Ademi i plotëson kushtet formale-juridike për t’iu nënshtruar procedurave të mëtutjeshme të përzgjedhjes për këtë vend pune, respektivisht për të vazhduar me shqyrtimin e të arriturave profesionale-akademike të kandidatit në përputhje me dispozitat dhe kushtet e cekura në preambulën e këtij konkursi.

Të dhëna bibliografike për kandidatin

Kandidati Haxhi Ademi u lind në Skenderaj më 26 gusht 1985. Në vitin akademik 2005/06 është regjistruar në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti Filozofik - Departamentin e Historisë, ku ka diplomuar më 06.05.2009 me temën: “Çështja Shqiptare në Kongresin e Berlinit”. Në vitin akademik 2010/11 është regjistruar në studimet e nivelit Master në Universitetin e Prishtinës, përkatësisht Fakultetin Filozofik – Departamentin e Historisë - Koha e Re, shek. XIX-XX dhe ka diplomuar më datë: 19.07.2013, me temën: “Arsimi shqip në Kosovë gjatë viteve 1941-1945”.

Kandidati Haxhi Ademi gjatë vitit akademik 2013/14 i vazhdoi studimet e Doktoratës (cikli i tretë) në drejtimin Histori Bashkëkohore, Departamenti i Historisë/Fakulteti Filozofik/Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, duke i përmbyllur ato me mbrojtjen me sukses të tezës “Pozita e shqiptarëve në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore 1941-1945”, për të siguruar kështu gradën shkencore “Doktor i shkencave të historisë”.

Punësimi dhe përvojat: Nga 7 korriku i vitit 2014 kandidati Haxhi Ademi është në marrëdhënie të rregullt pune në Institutin e Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, fillimisht në pozitën e *Hulumtuesit të pavarur shkencor për shek. XX* për të vazhduar nga korriku i vitit 2020 në pozitën e *Bashkëpunëtorit shkencor (prof. ass. dr.) për shek. XX*.

Në mbledhjen e Këshillit Shkencor të Institutin e Historisë “Ali Hadri”, më 23 dhjetor të vitit 2021 është zgjedhur *Shef (drejtues) i Departamenti të Historisë Bashkëkohore* në Institutin e Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë. Nga 1 tetori 2022 është i angazhuar në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, në Fakultetin Filozofik, Departamentin e Historisë, ku mban pozitën e “*Asistentit të angazhuar*”, në nivelin Bachelor dhe në nivelin Master, programi: Histori, Histori e Kohës së Re dhe Arkivistikë.

Aktiviteti kërkimor-shkencor dhe profesional

Bazuar në nenin 33 pika 2 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013) dhe nenit 5, pika 1.3.1 të Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë – që ka botuar së paku tri (3) punime shkencore në revistat relevante ndërkombëtare në kuadër të lëmisë dy (2) prej të cilave pas zgjedhjes së fundit - Shtojca I, pika A respektivisht A. 2.1, punimet e publikuara në revista ndërkombëtare të cilat janë të indeksuara në platformat akademike me 1 dhe pika A. 2.2, punimet e publikuara në revista kombëtare, të cilat janë të barasvlershme me 1, të Rregullores në fjalë, kandidati Haxhi Ademi ka këto punime të publikuara:

Nr	Emri dhe mbiemri	Titulli i punimit	Revista	Vëll. Nr. (viti), fq.	Linku i publikimit
1.	Haxhi Ademi	Some date on the massacre in village of Izbic, March	Anglisticu m.	Volume: 12 Issue: 10, P.10-20.	https://anglisticum.org.mk/index.php/IJLLIS/article/view/2407/2829

		1999		2023.	https://search.worldcat.org/search?q=anglisticum&offset=1
2.	Haxhi Ademi	Jeta politike në Kosovë në vitet e Luftës së Dytë Botërore (1941-1945)	Revista Kosova	Nr. 46 (2021)	Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2021
3.	Haxhi Ademi	The case of the “Displacement” of serbs from Kosovo Luring World War Two	<i>Analele University of Craiova analel Universitat ildin-Craiova-</i>	<i>Year XXIV, No.1 (35) 2019.</i>	https://www.istoriecraiova.ro/all-issues/issues/# https://www.scopus.com/results/authorNamesList.uri?sort=count-f&src=al&sid=02d3fca7e4a9fd723e69d853aa40e8d9&sot=al&sdt=al&sl=40&s=AUTHLASTNAME%28ademi%29+AND+AUTHFIRST%28haxhi%29&st1=ademi&st2=haxhi&orcidId=&selectionPageSearch=anl&reselectAuthor=false&activeFlag=true&showDocument=false&resultsPerPage=20&offset=1&jtp=false&currentPage=1&previousSelectionCount=0&tooManySelections=false&previousResultCount=0&authSubject=LFSC&authSubject=HLSC&authSubject=PHSC&authSubject=SOSC&exactAuthorSearch=false&showFullList=false&authorPreferredName=&origin=searchauthorfreeLookup&affiliationId=&txGid=8eb1bf500fc349659a13b995954af73d

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë, përkatësisht Shtojcës II, pika A, tabela 1.2: *Publikimet e monografive studimore, librave me dokumente në gjuhën shqipe*, kandidati Haxhi Ademi ka botuar si dhe ka në procedurë botimi këto studime monografike:

Nr.	Autori/autorët	Titulli	Lloji i botimit	Botuesi	Vendi dhe viti
1.	Haxhi Ademi	Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore (1941-1945)	Libër monografik	Instituti i Historisë Prishtinë	Prishtinë: 2021.
2.	Sabit Sylja, et. al, Haxhi Ademi	Drenica në fokusin e historisë	Libër monografik	Instituti i Historisë Prishtinë	Në procedurë botimi

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë, përkatësisht Shtojcës II, pika B, tabela 1.2: Publikimet nga sesionet, konferencat, simpoziumet, tryezat shkencore në nivel vendor, kandidati Haxhi Ademi ka të publikuara ose janë në proces të publikimit:

N r.	Autori/a utorët	Titulli i punimit	Konferenca	Botuesi dhe vendi	Vëllimi, nr. (viti), faqet
1.	Haxhi Ademi	“Përpjekjet për zgjerimin e Luftës Antifashiste në Kosovë dhe Konferenca e Bujanit”	Konferencë shkencore: "Konferenca e Bujanit: retrospektiva dhe rezultatet historike"	Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë, në Institutin Albanologjik – Prishtinë. Prishtinë: 8 dhjetor 2023. Në proces të publikimit.	
2.	Haxhi Ademi	“Krimet e forcave serbe në komunën e Skenderaj dhe Drenasit (1998-1999)”	Konferencë shkencore: “Gjenocidi serb kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX”	Instituti i Historisë “Ali Hadri” Prishtinë, Instituti i Historisë Tiranë, dhe Instituti Albanologjik Prishtinë, 7-8 prill 2022	fq.377-412
3.	Haxhi Ademi	“Masakra e Tivarit”	Konferencë shkencore: “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare 1912-1999”	Shoqata e Intelektualëve mbar shqiptarë “Trojet e Arbrit”, më 18 korrik 2021, në Skenderaj. Në proces të publikimit.	
4.	Haxhi Ademi bashkautor me Arjan Janoven,	“Roli i Kuvendit të Kosovës gjatë viteve '90 të shekullit XX”,	Konferencë shkencore: “Parlamentarizmi shqiptar ndër vite”	Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik-Departamenti-Historisë, mbajtur më 10 qershor 2021.	Fq.183-202

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë, përkatësisht Shtojcës II, pika C, tabela 1.1: Prezantime gojore-shkencore në konferenca, simpoziume, punëtori shkencorë dhe në universitete (si ligjërues i ftuar) nga fusha e kandidatit, kandidati Haxhi Ademi ka marr pjesë në këto konferenca shkencore:

Nr.	Autori/a utorët/ Prezantuesi	Titulli i kumtesës	Emri i konferencës, simpoziumit, organizatori	Vendi dhe viti
1.	Haxhi	I angazhuar	Asistent i angazhuar në programet: Histori,	Viti akademik

	Ademi		Histori e Kohës së Re dhe Arkivistikë Niveli: Bachelor dhe Master, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti Filozofik/Departamenti i Historisë	2022/23 dhe 2023/24
2.	Haxhi Ademi	“Shotë Galica simbol i rezistencës kombëtare shqiptare”	<i>Konferencë shkencore:</i> “Refleksione historiografike mbi masakrën serbe në Zogori (Zogaj-Dumnicë) – 100 vjet pas”. Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti Filozofik-Departamenti i Historisë, Instituti për Studime Sociale dhe Humanistike dhe Komuna e Vushtrisë	Vushtrri, 9 shkurt 2024
3.	Haxhi Ademi	Arnavut Devletinin Kurulmasında Romanya'daki Arnavut Kültür Topluluklarının Faaliyetleri	Sempozyum Programi Symposium Program GAÜN MAVERA KONGREVE SANAT MERKEZİ.	Turqi 14-16 dhjetor 2023
4.	Haxhi Ademi	“Përpjekjet për zgjerimin e Luftës Antifashiste në Kosovë dhe Konferenca e Bujanit”	<i>Konferencë shkencore:</i> Konferenca e Bujanit: retrospektiva dhe rezultatet historike”, Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë, në Institutin Albanologjik – Prishtinë.	Prishtinë 8 dhjetor 2023
5.	Haxhi Ademi Skender Lutfiu	“Përpjekjet për konsolidimin e shtetit shqiptar gjatë viteve 1920- 1924”	<i>Konferencë shkencore:</i> “Rruga e shqiptarëve drejtë pavarësisë dhe shtetndërtimi” Akademia e Studimeve Albanologjike Tiranë	Tiranë 24 nëntor 2022
6.	Haxhi Ademi	“Ferizaj gjatë Luftës së Dytë Botërore”	<i>Konferencë shkencore:</i> “Ferizaj në rrjedhat e historisë” Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik- Departamenti-Historisë, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinës dhe Komuna e Ferizajt.	Ferizaj 9 qershor 2023
7.	Haxhi Ademi	“Kontributi i Hasan Prishtinës për çështjen e shqiptarëve në Mbretërinë e Jugosllavisë nëpërmjet peticioneve e memorandumeve dërguar Lidhjes së Kombeve (1927- 1931)”,	<i>Konferencë shkencore:</i> “110 vjetori i Kryengritjes së përgjithshme dhe shtetit të shtetit të pavarur shqiptar: roli i Hasan Prishtinës” Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik- Departamenti-Historisë dhe Komuna e Vushtrisë.	Vushtrri 10 qershor 2022
8.	Haxhi Ademi	“Dispacment of the albanine population from	Konferencë shkencore ndërkombëtare “6 th Internacional Vongress of Eurasian Social Science ICOESS-2022	Turqi, Bodrum 13-16 maj 2022

		Kosovo to Turkey (1937-1941)",		
9.	Haxhi Ademi	"Krimet e forcave serbe në komunën e Skenderaj dhe Drenasit (1998-1999)"	<i>Konferencë shkencore:</i> "Gjenocidi serb kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX" Instituti i Historisë "Ali Hadri" Prishtinë, Instituti i Historisë Tiranë, dhe Instituti Albanologjik.	Prishtinë 7-8 prill 2022
10.	Haxhi Ademi	"Masakra e Tivarit"	<i>Konferencë shkencore:</i> "Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare 1912-1999", Shoqata e Intelektualëve mbar shqiptarë "Trojet e Arbrit"	Skenderaj 18 korrik 2021
11.	Haxhi Ademi Arjan Janova	"Roli i Kuvendit të Kosovës gjatë viteve '90 të shekullit XX",	<i>Konferencë shkencore:</i> "Parlamentarizmi shqiptar ndër vite" Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik-Departamenti-Historisë.	Prizren, 10 qershor 2021

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë, përkatësisht Shtojcës II, pika C, tabela 1.2: Kryeredaktor, redaktor shkencor, recensues në botime monografike, dokumente dhe përmbledhje:

Nr.	Kontributi (redaktor, recensues...)	Autori origjinal i librit	Titulli i librit	Vendi dhe viti
1.	Haxhi Ademi Anëtar i këshillit të redaksisë	Përmbledhje kumtesash	"Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë" Përmbledhje kumtesash nga konferenca shkencore ndërkombëtare e mbajtur me rastin e 30-vjetorit.	Vëllimi I. Botuar nga Instituti Albanologji i Prishtinës dhe Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, Prishtinë 2021.
2.	Haxhi Ademi Anëtar i këshillit të redaksisë	Përmbledhje kumtesash	"Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë", Përmbledhje kumtesash nga konferenca shkencore ndërkombëtare e mbajtur me rastin e 30-vjetorit.	Vëllimi II. Botuar nga Instituti Albanologji i Prishtinës dhe Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, Prishtinë 2021.
3.	Haxhi Ademi Recensent	Fahredin Shabani	"Çështja e alfabetit në mendimin politik të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1879-1912"	Botuar nga Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", Prizren, 2021.

4.	Haxhi Ademi Recensent	Përmbledhje kumtesash	“RUGOVA: KRYENGRITJA DHE MASAKRAT MË 1918- 1919”, Përmbledhje kumtesash nga simpoziumi shkencor “100-vjetori i kryengritjes dhe masakrave të Malit të Zi dhe të Serbisë në Shtupeq dhe në katundet të tjera të Rugovës, më 1919”.	Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, 2022
5.	Haxhi Ademi Anëtar i këshillit të redaksisë		“Katalog botimet e Institutit të Historisë (1967- 2022)”	Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, 2022
6.	Haxhi Ademi Recensent	Ragip Gjoshi.	“Flamurasi (Sankoci) ndër shekuj”	Prishtinës, 2023.
7.	Haxhi Ademi Redaktor shkencor	Përmbledhje kumtesash nga konferenca shkencore për Demonstratat e vitit 1981	Përmbledhje kumtesash “Pranvera e madhe shqiptare – 40 vjet nga Demonstratat e vitit 1981”	Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinës, 2023
8	Haxhi Ademi Recensent	Shkodran Imeraj	“Masakra në Pastasel 31 mars 1999”	Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinës, 2023
9.	Haxhi Ademi Recensent	Ibrahim Gashi	“STUDIME HISTORIKE II”	Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinës, 2023.

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë, përkatësisht Shtojcës II, pika C, tabela 1.4: **Kontribute tjera profesionale-shkencore:**

Nr.	Autori/autorët	Lloji i kontributit shkencor	Vendi dhe viti
1	Haxhi Ademi bashkautor me Skender Lutfiu	“Pasqyrimi i demonstratave të 1 tetorit 1997 në shtypin e shtetit shqiptar”	BULETINI I FAKULTETI FILOZOFIK, Nr. XXX (2017- 2018) XXXI (2019-2020). Prishtinë: Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti Filozofik, 2020.
2.	Haxhi Ademi:	“Organizimi shtetëror nën udhëheqjen e Rexhep Mitrovicës”.	GJURMIME ALBANOLOGJIKE, Nr. 51. Instituti Albanologjik, Prishtinë: 2021.
3.	Haxhi Ademi bashkautor me Arijan Janoven:	“Roli i Kuvendit të Kosovës gjatë viteve '90 të shekullit XX”	BULETINI I FAKULTETI FILOZOFIK, Nr. XXXII (2021). Prishtinë: Universiteti i

			Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti Filozofik, 2021.
4.	Haxhi Ademi	“Masakrat mbi popullsinë shqiptare gjatë Luftë së Dytë Botërore”	<i>SHENJA- Një shekull gjenocid, Vitit XI, Nr. 129, Janar 2022.</i>
5.	Haxhi Ademi	“Përpjekjet serbe-jugosllave për shpërngulja e popullsisë shqiptare”	<i>SHENJA- Dekomunistizimi i kombit, Vitit XII, Nr. 138, Tetor 2022</i>
6.	Haxhi Ademi	Anëtar i këshillit organizativ të: Konferencë shkencore: “Gjenocidi serb kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX”, Instituti i Historisë “Ali Hadri” Prishtinë, Instituti i Historisë Tiranë, dhe Instituti Albanologjik Prishtinë.	Prishtinë, 7-8 prill 2022
7.	Haxhi Ademi	Shef (drejtues) i Departamenti të Historisë Bashkëkohore	Në mbledhjen e Këshillit Shkencor të Institutit të Historisë “Ali Hadri” më 23 dhjetori i viti 2021- vazhdon
8.	Haxhi Ademi	Anëtar i Redaksisë së Revistës shkencore KOSOVA	Botues Instituti i Historisë “Ali Hadri”, nga vitit 2022.
9.	Haxhi Ademi	Recensent i disa punimeve të dorëzuara për t’u botuar në kuadër të punimeve të konferencës shkencore: “Gjenocidi serb kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX”.	
10.	Haxhi Ademi	Anëtar i këshillit organizativ për prezantimin e botimeve të Institutit të Historisë në Panairin e librit në Tiranë	Tiranë, prill 2022
11.	Haxhi Ademi	Anëtar i Këshillit Organizues si dhe fjala e mbylljes	Konferencë Shkencor Ndërkombëtare “Roli i grave në jetësimin e shtetit të Kosovës” organizuar nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë, Instituti i Historisë i ASA - Tiranë, Prishtinë: 5 maj 2023,.
12.	Haxhi Ademi	Anëtar i Këshillit Organizues, referues si dhe fjala e mbylljes.	Konferencë Shkencore “Konferenca e Bujanit: retrospektiva dhe rezultatet historike”, organizuar nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë, mbajtur në Institutin Albanologjik – Prishtinë. Prishtinë: 8 dhjetor 2023,
13.	Haxhi Ademi	Anëtar i këshillit organizativ për prezantimin e botimeve të Institutit të Historisë në Panairin e librit në Tiranë	Tiranë, prill 2024

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë, përkatësisht Shtojcës II, pika D, tabela 1.1: Pjesëmarrje e dëshmuar në programe ose projekte të kërkimeve shkencore:

Nr.	Programi/projekti shkencor	Periudha kohore	Pozicioni në projekt	Institucioni dhe vendi
1.	Historia e Kosovës	2020-2022s	Studiues	Instituti i Historisë Prishtinë
2.	Gjenocidi kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX	2021-2023	Studiues	Instituti i Historisë Prishtinë
3.	Drenica në fokusin e historisë I dhe II	2022-2024	Studiues	Instituti i Historisë Prishtinë

KONKLUZION

Bazuar në dokumentacionin e nevojshëm dhe kushtet e konkursit të shpallur nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, të publikuar gazetën “Epoka e Re” e datës 5 prill 2024 dhe në ueb faqen e Institutit të Historisë “Ali Hadri” Prishtinë <https://ih-rks.org/konkurse/Konkurs-Bashkepunter-i-larte-shkencor-5.4.2024.pdf> për vendin e punës *Bashkëpunëtor i lartë shkencor për shekullin XX– zgjedhje/rizgjedhje*, dhe bazuar në nenet 30, 31, 33 dhe 35 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, neneve 29, 30, 31, 32, 33 dhe 34 të Statutit të Institutit të Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, dhe nenet 3, 5, 9, 11, 12 dhe 13 të Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin e Historisë “Ali Hadri” Prishtinë, Komisioni recensues në përbërje prof. dr. Sabit Sylja - kryetar, prof. dr. Ibrahim Gashi – anëtar, dhe akad. Prof. asoc. dr. Alban Dobruna – anëtar, ka arritur këtë konkluzion:

Kandidati Haxhi Ademi ka paraqitur dëshmi të publikimi të tre (3) punimeve shkencore nga fusha dhe nga periudha përkatëse e studimit, të indeksuara në platforma relevante ndërkombëtare apo kombëtare në pajtim me nenin 33 pika 2 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), nenit 29 të Statutit të Institutit të Historisë dhe me nenin 5, pikat 1.3.1 të Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë, të paraqitura në tabelën e parë. Duhet shtuar se të gjitha punimet e cekura më lartë janë të indeksuara në platforma ndërkombëtare në pajtim me kriteret e mësipërme, të dëshmuara nga linqet aktive në kohën e këtij recensionit, apo të barasvlefshme me 1 pikë dhe i përkasin ekskluzivisht periudhës studimore që mbulon kandidati, pra atë të shekullit XX, njëjtë sikurse edhe monografitë.

Kandidati Haxhi Ademi ka paraqitur dëshmi të publikimi të një monografie shkencore si autor i vetëm dhe të një monografie në proces botime si bashkë-autor në pajtim me nenin 5, pikat 1.3.1 të Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe

hulumtuesve të Institutit të Historisë, të paraqitura në tabelën e dytë. Duke qenë se neni 4, pika 1.3.1 e Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë konsideron se një monografi është e barasvlefshme me dy punime shkencore, respektivisht po sipas të njëjtës një punim shkencor është i barasvlefshëm me një vëllim me dokumente, atëherë pjesa e mbetur nga monografitë e paraqitura shfrytëzohen për të barasvlerësuar vëllimin me dokumente në pajtim me nenin dhe pikat përkatëse të cekura më sipër (neni 4, pika 1.3.1 e Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë).

Dëshmitë e parashtruara argumentojnë pjesëmarrjen e kandidatit Haxhi Ademi në një numër të madh të konferencave, tryezave dhe të aktiviteteve tjera shkencore vendore dhe ndërkombëtare të përshkruara më lartë në fletë tabelare, duke u përfshirë edhe në projektet shkencore individuale dhe kolektive, kryesisht brenda fushës së përcaktuar. Në cilësinë e studiuesit kandidati në fjalë është i përfshirë në projektin e Historisë së Kosovës, projektin Gjenocidi që drejtohet nga Instituti i Historisë, po ashtu në cilësinë e studiuesit është i përfshirë edhe në projektin e Historisë së Drenicës. Në këtë mënyrë kandidati demonstroi përvojë afatgjate në kërkime shkencore të drejtuara nga institucione relevante.

Duke marr parasysh argumentet e cekura më lartë si dhe përgatitjen adekuate për periudhën e caktuar dhe përvojën e krijuar brenda Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, Komisioni recensues ka ardhur në përfundim se kandidati prof. ass. dr. Haxhi Ademi ka të arritura dhe kontribute shkencore të profilizuara për periudhën e caktuar, kualifikimin dhe përvojën e duhur, që i mundësojnë zgjedhjen dhe vazhdimin e marrëdhënies së punës sipas pozitës së kërkuar në konkurs, respektivisht ka plotësuar gjitha kushtet e parapara me nenin 33 pika 2 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), nenit 29 të Statutit të Institutit të Historisë dhe me nenin 5 - Shtojcat I-A, II-B, C dhe D të Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë në Prishtinë.

Propozim

Komisioni recensues në përbërje prof. dr. Sabit Syla - kryetar, prof. dr. Ibrahim Gashi anëtar, dhe Prof. asoc. dr. Alban Dobruna – anëtar, bazuar në kriteret dhe dispozitat ligjore të përcaktuara në preambulë të këtij konkursi, dhe në të arriturat profesionale-shkencore të përshkruara dhe të dokumentuara më lartë, për vendin e punës *Bashkëpunëtor i lartë shkencor për shekullin XX- zgjedhje/rizgjedhje*, në Institutin e Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, propozon kandidatin prof. ass. dr. Haxhi Ademi.

Komisioni recensues:

Prof. dr. Sabit Syla – kryetar

Prof. dr. Ibrahim Gashi – anëtar

Pof. asoc. dr. Alban Dobruna – anëtar

